



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Programi i IPA-s për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) Kosovë - Shqipëri 2010-2013

Konkurs për vend të lirë të punës:

Task Menaxher – Sekretariati i Përbashkët Teknik në Kukës, Shqipëri (1 pozitë)

Kosova merr pjesë në programin e IPA-s për Bashkëpunim Ndërkufitar Kosovë-Shqipëri (2010-2013) të financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i programit është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave kufitare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Për zbatimin e programit të BNK-së është themeluar Sekretariati i Përbashkët Teknik me staf nga Kosova dhe Shqipëria, i cili gjendet në Kukës, Shqipëri si dhe Zyra Koordinuese (Antena), e cila gjendet në Prizren, Kosovë.

Për të mbështetur zbatimin e programit të BNK-së do të punësohet një punonjës lokal në pozitën:

- **Task Menaxher** (me orar të plotë), i cili do të vendoset në Sekretariatit e Përbashkët Teknik në Kukës, Shqipëri.

Detyrat kryesore (jo shteruese): që do të kryhen përfshijë;

- Menaxhon, zbaton, monitoron dhe raporton për programin e BNK-së;
- Ndihmon në iniciimin, kontraktimin dhe zbatimin e skemave të granteve të BNK-së;
- Ndihmon në trajnimin e aplikantëve përfundimtar në lidhje me grantet e financuara nga programi i BNK-së;
- Pranon, analizon dhe përcjell në vazhdimësi raportet mujore të progresit të dërguara nga përfituesit; përgatit draft-raporte përmbledhëse në lidhje me raportet mujore të progresit;
- Përgatitë një orar indikativ të vizitave monitoruese;
- Përpilon draft-raportin vjetor të zbatimit;
- Mbledh raportet teknike nga përfituesit;
- Ofron ndihmë administrative dhe logjistike strukturave operative dhe Komitetit të Përbashkët Monitorues dhe Komitetit të Përbashkët Drejtues;
- Detyra të tjera të ndërlidhura me zbatimin e programit sipas kërkesës së udhëheqësit të SPT-së.

Kualifikimi i kërkuar

- Së paku 3 (tre) vjet përvojë pune;
- Diplomë universitare;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Përvojë praktike në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve;
- Përvojë të mëparshme në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar ose programet /projektet e BE-së; Njohuri kompjuterike (MS Office, Internet); Shkathtësi dhe gatishmëri për të udhëtuar në zonat kufitare.

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Dëshmi të kualifikimit dhe përvojës së punës;
- Curriculum Vitae (CV) dhe një letër motivimi në gjuhë angleze;
- Dëshmi që është shtetas/e i/e Kosovës;
- Formulari për aplikim i MAPL-së, në gjuhë shqipe dhe serbe

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal/Divizioni i Burimeve Njerëzore, Adresa: Objekti qeveritar (ish ndërtesa e "Rilindjes") kati i XII zyra nr. 1203 prej orës 08:00 deri ne 16:00: Aplikacioni mund të tërhiqet nga faqja zyrtare e MAPL-ës "mapl.rks-gov.net", gjithashtu aplikacionet mund të dërgohen me postë në adresën e lartshënuar.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit.

Për informata shtesë rreth aplikimit mund të kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore në tel: 038-200-35-568.